



Republika e Kosovës  
Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

ZYRA E KRYEMINISTRIT/URED PREMIJERA/OFFICE OF THE PRIME MINISTER  
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/  
AGENCY OF GENDER EQUALITY

PLANI I VEPRIMIT TË KOSOVËS PËR  
FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE  
2011 – 2013

AKCIONI PLAN ZA EKONOMSKO  
JA ANJE ŽENA  
2011 – 2013

KOSOVO ACTION PLAN FOR THE ECONOMIC  
EMPOWERMENT OF WOMEN  
2011 – 2013

PJESA I: SFONDI.....	5
1.1 Hyrje.....	5
1.2 Struktura e Planit të Veprimit për Fuqizimin Ekonomik të Grave.....	5
1.3 Zhvillimi i gjinive në Kosovë.....	5
1.4 Sfidat.....	6
1.5 Arsyet për Planin e Veprimit.....	6
1.6 Vizioni, objektivat dhe aktivitetet.....	6
PJESA II: KORNIZA E IMPLEMENT.....	8
2.1 Rolet dhe përgjegjësitë.....	8
2.1.1 Agjencia për barazi gjinore.....	8
2.1.2 Ministritë e sektorëve.....	8
2.1.3 Autoritetet lokale.....	8
2.1.4 Shoqëria civile.....	9
2.1.5 Partnerët zhvillimorë.....	9
PJESA III: MONITORIMI, VLERËSIMI DHE HULUMTIMI .....	9
3.1 Monitorimi dhe vlerësimi.....	9
3.2 Plani i implementimit.....	9
3.3 Qëllimet dhe politikat e zhvillimit sektoral dhe kombëtar .....	9
3.3 Lidhja ndërsektorale dhe harmonizimi .....	10
3.4 Indikatorët.....	10
3.5 Organizimet institucionale për monitorim dhe vlerësim.....	10
3.6 Hulumtimet .....	10
4. PJESA IV: KORNIZA LOGJIKE DHE MATRICA .....	11
ODELJAK I: OSNOVNE INFORMACIJE.....	43
1.1 Uvod .....	43
1.2 Pregled Akcionog plana za ekonomsko ja anje žena.....	43
1.3 Razvoj rodni pitanja na Kosovu.....	43
1.4 Izazovi.....	44
1.5 Obrazloženje za Akcioni plan.....	44
1.6 Vizija, specifi ni ciljevi i aktivnosti.....	44
1.7 Veze sa drugim nacionalnim politikama.....	45
ODELJAK II: OKVIR ZA SPROVOĐENJE.....	45
2.1 Uloge i odgovornosti.....	45
2.1.1 Agencija za rodnu jednakost.....	45
2.1.2 Sektorska ministarstva.....	46
2.1.3 Lokalne vlasti.....	46
2.1.4 Gradansko društvo.....	46
2.1.5 Razvojni partneri.....	46

ODELJAK III: PRACENJE, OCENJIVANJE I ISTRAŽIVANJE.....	47
3.1 Pracenje i ocenjivanje.....	47
3.2 Plan sprovođenja .....	47
3.3 Nacionalni i sektorski razvojni ciljevi i politika.....	47
3.3 Medusektorska povezanost i sinergija.....	47
3.4 Pokazatelji.....	47
3.5. Institucionalni aranžmani za pra enje i ocenjivanje .....	47
3.6 Istraživanje.....	48
 ODELJAK IV: LOGICKI OKVIR I LOGICKA MATRICA.....	 49
SECTION I: BACKGROUND.....	77
1.1 Introduction .....	77
1.2 Layout of the Action Plan for Economic Empowerment of Women.....	77
1.3 Gender Development in Kosovo.....	77
1.4 Challenges.....	78
1.5 Rationale for the Action Plan.....	78
1.6 Vision, Objectives and Activities.....	78
1.7 Links to other National Policies.....	79
 SECTION II: IMPLEMENTATION FRAMEWORK.....	 79
2.1 Roles and Responsibilities.....	79
2.1.1 Agency for Gender Equality.....	79
2.1.2 Sector Ministries.....	80
2.1.3 Local Authorities.....	80
2.1.4 Civil Society .....	80
2.1.5 Development Partners.....	80
 SECTION III: MONITORING, EVALUATION AND RESEARCH.....	 81
3.1 Monitoring and Evaluation.....	81
3.2 Implementation Plan.....	81
3.3 National and Sectoral Development Goals and Policies.....	81
3.3 Intersectoral Linkage and Synergies.....	81
3.4 Indicators.....	81
3.5. Institutional Arrangements for Monitoring and Evaluation .....	81
3.6 Research.....	82
 SECTION IV: LOGICAL FRAMEWORK AND MATRIX.....	 83



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

ZYRA E KRYEMINISTRIT // OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA  
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/  
AGENCY OF GENDER EQUALITY

---

**PLANI I VEPRIMIT TË KOSOVËS PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE**  
2011 – 2013



## PJESA I: SFONDI

### 1.1 Hyrje

Zhvillimi socio-ekonomik i Kosovës dhe përparimi i saj i përgjithshëm varet nga shfrytëzimi i plotë i burimeve të saj njerëzore, si femrave ashtu edhe meshkujve. Margjinalizimi i vazhdueshëm dhe shfrytëzimi jo i mjaftueshëm i grave që në shifra janë 860,274<sup>1</sup> e popullatës së përgjithshme është një pengesë madhore ndaj zhvillimit të shpejtë socio-ekonomik të vendit.

Qeveria e Kosovës ka marrë masa për të trajtuar shqetësimet për çështjet gjinore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me hartimin dhe miratimin e legjislacionit specifik që trajton përfaqësimin e grave të Kosovës dhe statusin e pjesëmarrjes dhe mirëqenien dhe me integrimin e perspektivës gjinore nëpërmjet politikave të ndryshme makro dhe mikro, strategjive dhe programeve.

Kushtetuta e Kosovës kërkon që përbërja e Kuvendit të Kosovës duhet të respektojë parimet e njohura ndërkombëtarisht të barazisë gjinore (neni 71:2), ndërsa Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme kërkon nga partitë politike respektimin e kuotës gjinore që kërkon që 30% e të gjithë kandidatëve të jenë femra, (neni 27.1). Përveç kësaj, Kosova ka miratuar dhe respekton Ligjin për Barazinë Gjinore, (2004/2), Ligjin për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje, Ligjin për Shëndetin Riprodhues, dhe kështu me radhë. Më tej, një numër i strategjive dhe veprimeve janë ndërmarrë nga qeveria në vitet e fundit për të avancuar statusin e grave në Kosovë si Programi i Kosovës për Barazi Gjinore dhe Programi i Kosovës kundër dhe Plani i Veprimit 2011-2014. Në vitin 2009, Kuvendi i Kosovës nënshkroi rezolutën e Qëllimeve Zhvillimore të Mijëvjeçarit që tregon përkushtimin për arritjen e QZHM-ve deri në vitin 2015.

Për të siguruar implementimin efektiv të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, në veçanti objektivat programore të tij në lidhje me fuqizimin ekonomik të grave, një plan veprimi për fuqizimin ekonomik të grave në Kosovë për të promovuar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë dhe për të forcuar të drejtat e grave që u mundëson atyre që të kenë kontroll mbi jetën e tyre dhe të ushtrojnë ndikim në shoqëri është përgatitur nga Agjencia e Kosovës për Barazi Gjinore. Ky Plan Veprimi mbulon fushat kyçe të problemeve gjinore të parapara në Programin për Barazi Gjinore.

### 1.2 Struktura e Planit të Veprimit për Fuqizimin Ekonomik të Grave

Plani i veprimit është paraqitur në pesë pjesë. Pjesa Një përmban informata për sfondin, që përfshin hyrjen, sfidat, arsyet, vizionin, objektivat strategjike dhe qëllimet, dhe lidhjet me politikat tjera të Kosovës. Pjesa e Dytë është për Kornizën e implementimit të Planit të Veprimit ndërsa Pjesa e Tretë jep detajet e Monitorimit, Vlerësimit dhe Hulumtimeve dhe Pjesa e Pestë është Korniza Logjike dhe Matrica.

### 1.3 Zhvillimi i gjinive në Kosovë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përkrah barazinë gjinore dhe drejtësinë dhe garanton pjesëmarrjen e plotë të grave dhe burrave në jetën sociale, ekonomike dhe politike. Qeveria gjithashtu është duke zbatuar angazhimet ndërkombëtare që mbrohen në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe në Deklaratën e të

---

<sup>1</sup> SEK

Drejtave të Njeriut (1948), Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) (1979), Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve (CRC) (1989), Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim (1995), Samitin Botëror 2005, Rezolutën për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, Politikën për Gratë dhe Zhvillimin Gjinor (2000), Adendumin mbi Parandalimin dhe Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe Fëmijëve (1998). Pavarësisht nga përpjekjet për të zbatuar këto Deklarata dhe konventa, pabarazitë gjinore ende ekzistojnë në aspekte të ndryshme.

Qeveria ka krijuar edhe mekanizmat për formulimin e politikave gjinore, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të politikës së zhvillimit gjinor, programe dhe plane të integritit gjinor. Mekanizmat përfshijnë themelimin e Agjencisë për Barazi Gjinore që është përgjegjëse për zhvillimin gjinor, vendosjen e zyrtarëve gjinorë në ministri, departamentet e pavarura dhe komuna.

#### 1.4 Sfidat

Zakonet dhe traditat që diskriminojnë gratë vazhdojnë të përjetësojnë pabarazitë gjinore, kapacitetin gjinor dhe aspektet institucionale. Ngjashëm, përpjekjet për të promovuar barazinë gjinore dhe barazinë hasin sfidat e mëposhtme:

- Fuqizimin e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë në bazë të meritës;
- Të siguruarit që politikat makro dhe mikro i marrin parasysh çështjet gjinore;
- Të siguruarit që korniza ligjore i merr parasysh çështjet gjinore;
- Forcimi i mekanizmave institucionale për zhvillimin gjinor;
- Të siguruarit e partneriteteve të qëndrueshme dhe bashkëpunimit;
- Të siguruarit që janë në dispozicion resurset adekuate për të trajtuar pabarazitë gjinore dhe
- Kapacitetet joadekuate për koordinimin, monitorimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe përcjelljen e implementimit të politikave, strategjive, planeve dhe programeve.

#### 1.5 Arsyet për Planin e Veprimit

Arsyet për Planin e Veprimit janë që të udhëzohet implementimi i mëtejshëm i politikës zhvillimore gjinore dhe të grave, konventave, ligjeve dhe programeve. Brenda kontekstit të Programit të Kosovës për barazi gjinore në mënyrë specifike Plani i Veprimit është i dizajnuar të udhëheqë palët e interesuara që të:

- Shpejtojnë implementimin e progresit të Politikës për zhvillimin gjinor dhe të grave;
- Shpejtojnë implementimin e angazhimeve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave;
- Integrojnë çështjet gjinore në politika makro dhe sektorale;
- Lidhen me partnerët bashkëpunues dhe organizatat civile;
- Zgjerojnë koordinimin, llogaridhënien, monitorimin, vlerësimin dhe hulumtimin.

#### 1.6 Vizioni, objektivat dhe aktivitetet

Vizioni i këtij plani të veprimit mbetet ai i Programit për barazi gjinore që thekson që:

*Kosova do të jetë vendi ku të gjithë qytetarët (gratë dhe burrat) do të kenë mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje, të drejta të barabarta për arsim, punësim, qasje të lirë dhe të barabartë në të gjitha shërbimet publike ashtu që të gëzojnë rezultatet e punës së tyre.<sup>2</sup>*

<sup>2</sup> Siç është formuluar në Programin Kosovar për Barazi Gjinore, 2008-2013, fq. 117

Plani i veprimit përmes dy objektivave specifike të tij synon të arrijë:

- Të përmirësojnë ndjeshëm pjesëmarrjen e grave dhe të ngrisë statusin e tyre në tregun e punës
- Të përkrahë ndërmarrësinë e grave dhe të arrijë qasje dhe shfrytëzim të barabartë të pronës dhe resurseve natyrore.

Objektivat do të arrihen përmes një numri të veprimeve që bien nën pesë aktivitete kryesore:

- Rritja e qasjes dhe përfaqësimit të grave në institucionet e administratës publike dhe ndërmarrjet publike,
- Rritja e qasjes dhe punësimit të grave në sektorin privat,
- Rritja e ndërmarrësisë në mesin e grave,
- Të siguroarit që partneritetet publiko-private dhe investimet i përgjigjen nevojave socio-ekonomike të grave,
- Përkrahja e programeve që promovojnë qasjen, kontrollin dhe pronësinë e grave mbi resurset.

### 1.7 Lidhjet me politikat tjera kombëtare

Plani i veprimit për Fuqizimin Ekonomik të Grave ndërton mbi bazën e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, 2008-2013, Strategjisë për Arsim të Lartë, Strategjisë për Zhvillim Rural, Strategjisë për Punësim në Kosovë, Strategjisë së Kosovës dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve, Strategjisë për Reformën në Administratën Publike.



## PJESA II: KORNIZA E IMPLEMENTIMIT

Kjo pjesë shpjegon masat e implementimit për Planin e Veprimit për fuqizimin ekonomik të grave, që përfshin rolet e institucioneve, përgjegjësitë dhe harmonizimin e proceseve të implementimit.

Objektivi kryesor i planit të implementimit është të identifikojë dhe të udhëzojë për veprime specifike të cilat ministritë, institucionet, agjencitë e pavarura, sektori privat, autoritetet lokale qeveritare, organizatat e shoqërisë civile, organizatat komunitare dhe komunitetet do të ndërmarrin në planet afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata.

Qeveria do të krijojë një mjedis të përshtatshëm për pjesëmarrje aktive të të gjitha palëve të interesuara.

### 2.1 Rolet dhe përgjegjësitë

#### 2.1.1 Agjencia për barazi gjinore

Agjencia për Barazi Gjinore është makineria kombëtare për zhvillimin gjinor në vend. Ajo do të jetë përgjegjëse për:

- Koordinimin e implementimit të strategjisë dhe të punojë afër me aktorët e tjerë,
- Sigurimin e përkrahjes profesionale për implementuesit e tjerë të zhvillimit gjinor,
- Raportimin e progresit të implementimit,
- Mbledhjen dhe shpërndarjen e programeve informative,
- Ofrimin e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për palët në ministritë e linjës, komunat dhe tjera sipas kërkesës për të implementuar me sukses Planin e Veprimit,
- Mbajtjen e bazës kombëtare të të dhënave gjinore.

#### 2.1.2 Ministritë e sektorëve

Ministritë e sektorëve do të jenë përgjegjëse për drejtimin e politikave sektoriale, mbikëqyrjen, koordinimin, implementimin dhe aktivitetet monitoruese, të cilat kontribuojnë drejt arritjes së barazisë gjinore dhe drejtësisë. Ato gjithashtu do të jetë përgjegjëse për identifikimin e aktiviteteve prioritare të hollësishme që do të ndërmerren gjatë implementimit të strategjisë.

#### 2.1.3 Autoritetet lokale

Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale do të koordinojë implementimin e programeve në nivel rajonal dhe të qarkut. Ajo do të jetë gjithashtu përgjegjëse për masat e zhvillimit të kapaciteteve në nivel të pushtetit lokal. Për më tepër, Ministria do të udhëheqë mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave gjinore të ndara nga niveli bazë në nivel kombëtar dhe anasjelltas.

Në nivelin e qarkut, autoritetet e pushtetit lokal (qarku/qyteti/ komuna/ këshilli i qytetit/fshatit) do të planifikojnë dhe implementojnë programe brenda fushave të tyre të juridiksionit në bashkëpunim me aktorë të tjerë, duke përfshirë komunitetet dhe familjet përmes procesit pjesëmarrës. Autoritetet lokale duhet të ndajnë burime të mjaftueshme për të përkrahur implementimin e Planit të Veprimit, si dhe për të monitoruar dhe raportuar progresin në barazinë gjinore, drejtësi dhe zhvillim. Ata gjithashtu do të jenë

përgjegjës për sensibilizimin e grupeve të ndryshme të synuara për çështjet gjinore dhe për të lehtësuar krijimin, përdorimin dhe shpërndarjen e të dhënave dhe informatave të ndara të gjinive.

#### 2.1.4 Shoqëria civile

Spektori i shoqërisë civile ka një rol të rëndësishëm në arritjen e barazisë gjinore dhe drejtësisë. Shoqëria civile do të përfshijë organizatat jo-qeveritare, të bazuara në komunitet dhe sindikatat. Rolet dhe përgjegjësitë e tyre do të përfshijnë zhvillimin e kapaciteteve lokale dhe fuqizimin e komuniteteve, duke marrë pjesë në monitorim dhe vlerësim, mobilizimin e burimeve të komunitetit dhe zgjerimin e pjesëmarrjes së komunitetit. Spektori i shoqërisë civile do të punojë afër me ministritë qeveritare, autoritetet lokale për të siguruar se gjinia është përfshirë në implementimin e planeve sektoriale, si dhe planeve komunale.

#### 2.1.5 Partnerët zhvillimorë

Partnerët zhvillimorë do të punojnë afër me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe aktorët tjerë kryesorë në implementimin e SKZH Gj-së. Ata do të shfrytëzojnë sistemet dhe proceset ekzistuese për të dhënë shërbime financiare, teknike dhe tjera përkrahëse. Ata gjithashtu do të lehtësojnë iniciativat e zhvillimit të kapacitetit të palëve të interesuara, qoftë qeveritare apo joqeveritare.

### PJESA III: MONITORIMI, VLERËSIMI DHE HULUMTIMI

#### 3.1 Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi dhe vlerësimi do të thotë përcjellja e implementimit të strategjive të zhvilluara për çdo fushë të fokusit për Planin e Veprimit për fuqizimin ekonomik të grave. Ky është një proces i vazhdueshëm që përfshin mbledhjen në kohë të informacionit në lidhje me aktivitetet e përditshme në rrjedhën e implementimit të strategjisë. Ky vlerësim është i nevojshëm për të nxjerrë në pah mangësitë në mënyrë që të merren veprimet korigjuese në vend se të pritët vlerësimi përfundimtar. Rezultatet e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit duhet të vihen në dispozicion për të gjitha palët për të mundësuar analizat ndër-sektoriale. Gjithashtu shërbejnë për të përcaktuar nëse të gjitha palët që marrin pjesë në implementimin e strategjisë i kanë marrë rezultatet që i dëshirojnë dhe nëse strategjia është duke dhënë rezultatet që janë paraparë gjatë fazës së hartimit të saj. Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit të Veprimit do të udhëhiqet nga të mëposhtmet:

#### 3.2 Plani i implementimit

Respektimi i Kornizës Logjike

#### 3.3 Qëllimet dhe politikat e zhvillimit sektoral dhe kombëtar

Respektimi i politikave dhe qëllimeve zhvillimore kombëtare dhe sektorale siç është paraparë në Kushtetutën e Shtetit ose politikat relevante sektoriale, strategjitë dhe legjislacionet.

### 3.3 Lidhja ndërsektorale dhe harmonizimi

Vëmendje për lidhjet ndërmjet fushës së çështjeve gjinore në strategji dhe strategjive specifike brenda çdo fushe të problemeve për të siguruar se ka konsistencë.

### 3.4 Indikatorët

Korniza logjike përmban objektivat, strategjitë, aktivitetet, indikatorët e performancës dhe pjesëmarrësit (aktorët) që do të shfrytëzohen për qëllim të monitorimit dhe vlerësimit si dhe kornizën kohore.

### 3.5 Organizimet institucionale për monitorim dhe vlerësim

Agjencia për Barazi Gjinore është e ngarkuar me koordinimin e iniciativave gjinore në vend prandaj ka përgjegjësinë e përgjithshme për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të kësaj strategjie në nivel kombëtar. Në kryerjen e përgjegjësisë së saj, si koordinatore e përgjithshme e kësaj strategjie, ajo do të punojë në bashkëpunim të afërt me strukturën e Qeverisë. Pikat fokale gjinore, të krijuara në strukturën e Qeverisë do të jenë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të strategjisë në institucionet e tyre përkatëse të juridiksionit. Në të njëjtën kohë, ato do të japin informacion mbi progresin e zhvillimit gjinor për Agjencinë për Barazi Gjinore. Agjencia do të punojë edhe me Entin Statistikor të Kosovës, institucionet kërkimore, institucionet akademike, sektorin privat, organizatat joqeveritare, mediat në mënyrë që të marrë të dhëna dhe informacione që do të inkorporohen në sistemin e monitorimit dhe raportimit të strategjisë.

### 3.6 Hulumtimet

Hulumtimet janë domosdoshmëri për identifikimin e çështjeve që do të kërkojnë intervenime për të përmirësuar strategjitë, metodologjinë, kriteret e performancës, kornizën e implementimit dhe vlerësimin.

PJESA IV: KORNIZA LOGJIKE DHE MATRICA

Vizioni

Kosova do të jetë vendi ku të gjithë qytetarët (gratë dhe meshkujt) do të kenë mundësi të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendim-marrje, të drejta të barabarta në arsimim, punësim, punësim, qasje të lirë dhe të barabartë në të gjitha shërbimet publike në mënyrë që të mund të gëzojnë rezultatet e punës së tyre.<sup>1</sup>

Qëllimi strategjik:

Arritja e fuqizimit ekonomik të grave në Kosovë

Qëllimi 1: Përmirësimi domethënës i pjesëmarrjes së grave dhe përmirësimi i gjendjes së tyre në tregun e punës

Aktivitetet	Veprimet	Treguesit	Mënyrat e vërtetimit	Institucion-i(et) përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Plani kohor	Resurset financiare
1.1 Ngritja e qasjes së grave si dhe përfaqësimi i tyre në institucionet e administratës publike dhe ndërmarrje publike	1.1.1 Ndërmarrja e një studimi për të vlerësuar barazinë e burrave dhe grave në vend të punës duke u përqendruar në komponentët kyç vijues: punësim, ngritje në pozitë, pagesë, zhvillim profesional dhe ndërmarrje të pozitave udhëheqëse (hulumtimi duhet të përfshijë të gjitha	Hulumtimi përmbushë standardet e hulumtimit të pranuar shkencëtarisht  Të dhënat e mbledhura dhe përpunuara disagregohen sipas etnicitetit, moshës dhe ceneshmërinë	Dokument shkencor hulumtimi	ABCJ	Të gjitha Ministrinë e linjës, Komunitet e Kosovës, ndërmarrjet publike, institucionet relevante	08/2011	€ 15,000

<sup>1</sup> Siç është e detajuar në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, 2008-2013, fq. 117

	<p>institucionet publike)</p> <p>1.1.2 Bazuar në zbulimet dhe rekomandimet e hulumtimit, draftimi dhe miratimi i vendimeve dhe dekreteve relevante qeveritare që sigurojnë përmbushjen e tyre dhe arrijnë kuotën e përfaqësimit (40%) në institucione publike siç kërkohet sipas Ligjit mbi barazinë gjinore, 3.1, 3.2</p>	<p>Nr. i vendimeve qeveritare të lëshuara</p> <p>Relevanca e vendimeve të tilla përballë rekomandimev e përkatëse</p> <p>Ligji për Barazi Gjinore dhe kuota prej 40% është arritur si në përfaqësim ashtu edhe zotërim të pozitave të larta menaxheriale dhe të lidershipit</p>	<p>Dekretet janë nxjerrë dhe zbatuar</p> <p>Raportet periodike mbi vlerësimin e të dhënave</p>	<p>ABGJ, MAP</p>	<p>Të gjitha Ministrinë e linjës, Komunitat e Kosovës, ndërmarrjet publike, institucionet relevante</p>	<p>2011-2013</p>	<p>Duhet të vlerësohet në bazë të dekreteve dhe rekomandi meve të tilla</p>
<p>1.1.3 Projektimi i programeve të trajnimit dhe mundësive të mësimt për gratë që përmirësojnë kapacitetet e tyre dhe iu mundësojnë atyre që të përparojnë në pozita të larta menaxheriale dhe udhëheqëse</p>	<p>Materialet e kurrikulave dhe të trajnimit janë përgatitur dhe ekzistojnë</p> <p>Nr. i seanceve të trajnimit janë kryer</p>	<p>Kurrikula dhe materialet trajnuese</p>	<p>IKAP</p>	<p>ABGJ, Donatorët, Universiteti i Prishtinës dhe universitetet private</p>	<p>2011</p>	<p>€ 25,000</p>	

<p>1.1.4 Ofrimi i mundësive të trajnimit dhe mësimin bazuar në një kurrikulë të zhvilluar që përmirëson kapacitetet dhe menaxheriale të grave</p>	<p>Nr. i grave të trajnuara kundrejt numrit të grave që kanë lëvizur drejt pozitave udhëheqëse/ menaxheriale</p>	<p>Njoftimi mbi seancat e trajnimit si dhe kalendari i seancave të trajnimit Mbledhja periodike e të dhënave mbi avancimin në karrierë të grave</p>	<p>IKAP</p>	<p>ABGJ, Donatorët, Zyrat për burime njerëzore</p>	<p>2011-2013</p>	<p>€ 12,000 vjetore</p>
<p>1.1.5 Përkrahja e mundësive të mësimin dhe avancimit akademik përmes alokimit të fondeve të veçanta në baza vjetore dhe shpërblyerje të grave që janë shërbyese civile bazuar në merita të performancës</p>	<p>Nr. i bursave që i jepen grave</p>	<p>Dekreti qeveritar mbi alokimin e fondeve</p>	<p>QRRK dhe donatorët</p>	<p>2011-2013</p>	<p>Duhet të vlerësohet</p>	
<p>1.1.6 Avokimi tek donatorët për të rritur dhe vazhduar procesin e rritjes dhe vazhdimin</p>	<p>Nr. i grave të cilat kanë përfituar nga</p>	<p>Dokumentet mbi kriteret përzgjedhëse për skemën e dhënies së bursave</p>	<p>Donatorët</p>	<p>2011-</p>	<p>Është nënshkruar marrëveshja</p>	

	të procesit të dhënies së bursave, p.sh. Skema Evropiane e Bursave për profesionistët e rinj, etj. dhe ruajtja e bilancit gjinor gjatë procesit të dhënies së bursave	skema e bursave të donatorëve  Ndërlidhja e bursës ndaj nevojave ekonomike dhe shoqërore	ndërmjet QRK-së dhe donatorëve  Janë dhënë gradat shkencore dhe diploma			2013	
--	---	--	---	--	--	------	--

**Qëllimi 1: Përmirësimi domethënës i pjesëmarrjes së grave dhe përmirësimi i gjendjes së tyre në tregun e punës**

Aktivitetet	Veprimet	Treguesit	Mënyrat e vërtetimit	Institucion-i(et) përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Plani kohor	Resurset financiare
1.2 Ngritja e pjesëmarrjes së grave si dhe punësimi në sektorin privat	1.2.1 Monitorimi i afërt nga perspektiva gjinore e zbatimit të Strategjisë për punësim të qëndrueshëm (SPQ) specifikiisht fushat vijuese të politikave: Shërbimet e punësimit publik, migrimi i fuqisë punëtore, programet e tregut të fuqisë punëtore aktive, mbrojtja e punësimit dhe mërijanimit i individëve nga skema për ndihmë sociale drejt punësimit të leverdishëm	Është themeluar sistemi i mbledhjes dhe raportimit të rregullt të të dhënave  Është përforcuar bashkëpunimi ndërmjet ABGJ dhe MPMS	Raportet dhe marrëveshja e bashkëpunimit	ABGJ, MPMS	ESK, REC	2011-2013	Nuk janë nevojitur, janë alokuar në SPQ
	1.2.2 Ndërmarrja e një rishikimi (desk review exercise) duke ushtruar	Është hartuar raporti i inventarizimit	Dokumenti i raportit	ABGJ	Të gjitha Ministrinë e linjës, sektori	10/2011	€ 12,000

<p>një analizë të perspektivës së gjinisë të të gjitha strategjive sektoriale të cilat synojnë përmirësimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës.</p>	<p>dhe përmban vërejtjet relevante</p>	<p>Regjistrat e punësimit</p>	<p>MPMS</p>	<p>REC, komunat,</p>	<p>2011-2013</p>	<p>Siç janë alokuar nën artikullin e linjës buxhetore vjetore për Programet e punës publike /MPMS</p>
<p>1.2.3 Futja në veprim dhe zbatimi, i kuotës së punësimit në programet e punëve publike (40%)</p>	<p>40% të individëve të punësuar janë gra</p> <p>Prioritet në punësim i jepet nënave që janë prind i vetëm, prindër të vetëm, grupeve minoritare dhe familjeve që jetojnë nën nivel të varfërisë</p>	<p>Publikimi i dokumentit të hulumtimit dhe shpërndarja e tij në sferën publike</p>	<p>ABGJ</p>	<p>MF, Sektorët jo-qeveritar, BB, ILO, UNDP, donatorët</p>	<p>2011</p>	<p>€ 25,000</p>
<p>1.2.4 Kryerja e hulumtimit mbi kontributin e papaguar të grave për zhvillimin ekonomik dhe përfshirjen e tyre në ekonominë jo-formale</p>	<p>Ndryshimet politike dhe legislative për të adresuar fuqizimin ekonomik të grave janë arritur</p> <p>Ngritja e programimit që përkrahë</p>					





	<p>1.2.6 Krijimi i një skeme vjetore shpërblyese ("Biznesi më i mirë i vitit") për bizneset të cilat punësojnë dhe promovojnë gratë në pozita menaxheriale si dhe praktikojnë trajtim të barabartë të grave në vend të punës</p>	<p>Është ulur niveli i ngacmimit seksual në vend të punës</p> <p>Ambienti i punës dhe produktiviteti janë përmirësuar</p> <p>Janë vendosur kriteret për skemën shpërblyese, p.sh. nr. i grave të punësuara, sipas faktorit të etnicitetit dhe paaftësisë, moshës, etj.</p> <p>Është themeluar një ngjarje për shpërblime biznesore si ngjarje e rregullt vjetore</p> <p>Nr. i grave të synuara dhe që përfitojnë nga aktivitetet e tilla% e grave që janë duke u nxjerrë nga</p>	<p>Ngjarje vjetore</p> <p>Raportet e monitorimit dhe vlerësimit</p> <p>Dekretet dhe rregulloret janë draftuar dhe miratuar</p> <p>Njoftimet përmes TV spoteve</p> <p>Raportet mbi stërvitjen/trajnimin</p>	<p>ABCJ dhe ZKM</p> <p>MTI, Oda Ekonomike e Kosovës</p> <p>2011-2013</p> <p>€ 5,000</p>	
--	--	--	--	---	--

	<p>1.2.7 Përfshirja e perspektivës gjimore në të gjitha kriteret publike të Qeverisë së Kosovës.</p>	<p>varfëria</p> <p>Janë themeluar kriteret, janë inkorporuar në rregullore mbi menaxhimin e financave publike dhe rregullore / politika ekonomike</p>	<p>Konferenca vjetore Procesi i konkurrencës dhe shpërblimet</p>	<p>ABGJ, MZHE, MF,MTI</p>	<p>Ministritë e linjës, AKP,</p>	<p>2011 – 2012</p>	<p>Nuk nevojitet</p>
	<p>1.2.8 Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave gjatë ngjarjeve të panairave të punës përmes shpërndarjes së informatave mbi vendndodhjen e ngjarjes, procesin dhe dhenien e trajnimeve mbi mënyrën në të cilën duhet të qasen punëdhënësit potencial:</p> <p>a) Shpallja e ngjarjeve përmes TV-së, mediave të shkruara dhe radios në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës,</p> <p>b) Angazhimi i entiteteve të specializuara për të</p>	<p>Nr. i grave që marrin pjesë në procesin e stërvitjes kundrejt numrit të grave që i nënshtrohen punësimit dobiprurës përmes ngjarjeve të panairit të punës</p> <p>Nr. i kompanive që hyjnë në procesin e konkurrencës</p>	<p>Të dhënat e mbledhura përmes anketave të rregullta dhe periodike</p>	<p>ABGJ</p>	<p>MPMS, MTL, ILO, UNIFEM, UNDP, Jo-qeveritare,</p>	<p>2011- 2013</p>	<p>€ 8,000 vjetore</p>

	<p>stërvitur dhe trajnuar gratë mbi procesin e njohurive të intervistimit dhe punësimit</p>			<p>ABGJ MTI</p>	<p>Mediet, Sindikatat, Universitetet, punëdhënësit publik dhe privat</p>	<p>2011- 2013</p>	<p>€ 10,000 vjetore</p>
	<p>1.2.9 Përzgjedhja dhe klasifikimi i top 20 punëdhënësve të vitit që janë miqësor ndaj familjes</p>	<p>Nr. i familjeve dhe grave që përfitojnë nga politikat e tilla Promovimi i politikave miqësore ndaj familjes në vend të punës</p>				<p>2011- 2013</p>	<p>€ 5,000 vjetore</p>
	<p>1.2.10 Inkurajimi i kompanive private-publike për mundësimin e ofrimit të stazheve praktikave të punës</p>	<p>Nr. i praktikanteve gra në kompani publike kundrejt numrit të atyre që marrin punësim të leverdishëm</p>		<p>Universitetet</p>	<p>ABGJ, ESK, Unionet studentore,</p>	<p>2011- 2013</p>	<p>€ 5,000 vjetore</p>

**Qëllimi 2: Përkrahja e grave ndërmarrëse dhe arritja e qasjes së drejtë dhe e shfrytëzimit të resurseve pronësore dhe natyrore**

Aktivitetet	Veprimet	Treguesit	Mënyrat e vërtetimit	Institucion-i (et) përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Plani kohor	Resurset financiare
2.1 Ngritja e ndërmarrësisë në mesin e grave	2.1.1 Rritja e ndjeshmërisë së entiteteve dhe organizatave të donatorëve që ofrojnë programe të mikro-financave për të synuar fuqishëm gratë si grupe të tyre të përfituesve si dhe të rrisin numrin e grave si kliente / përfituese të programeve të tyre	Janë themeluar ngjarje të rregullta të ndarjes së informatave dhe vendim-marrjes  Janë nënshkruar MM ndërmjet institucioneve qeveritare të Kosovës dhe donatorëve, dhe institucioneve financiare	MM, ngjarjet e organizuara dhe vendimet e ndërmarra	ABGJ	Të gjitha Ministrinë e linjës, entitetet lokale dhe ndërkombëtare mikrofinanciar e dhe të zhvillimit të biznesit	2011-2013	Nuk nevojiten
	2.1.2 Përkrahja e iniciativave që informojnë dhe trajnojnë gratë mbi të drejtat ekonomike dhe iniciativat afariste për të përmirësuar aftësitë ndërmarrëse të grave, njohuritë dhe iniciativat	Nr. i grave të arritura  Nr. i seancave të rritjes së ndjeshmërisë të mbajtura  Nr. i grave të arritura përmes kampanjave informative të	Janë mbajtur seancat e trajnimit, kampanjat e informacionit  Uebfaqet / portalet mbi informacionin e biznesit	ABGJ	MTI, MPMS, entitetet dhe shoqatat afariste mikro-ndërmarrje	2011-2013	€ 20,000 vjetore

	<p>2.1.3 Themelimi i një fondi të bursave për gratë e reja të cilat dëshirojnë të ndjekin studimet e administrimit të biznesit</p>	<p>kontaktimit Janë themeluar kiosqet e informimit Nr. i bursave të dhëna Nr. i grave të cilat kanë diplomuar suksesshëm nga programi dhe janë në gjendje të fillojnë bizneset e tyre apo të marrin pozita të larta në ndërmarrje private</p>	<p>Programi për alokimin e fondeve të dhënies së bursave</p>	<p>ABGJ, MASHT</p>	<p>Univerzitetet ,Komunat,MTI, Ndermarrjet Publike dhe Private</p>	<p>2011-2013</p>	<p>€ 25,000 vjetore</p>
<p>2.1.4 Përkrahja e programeve të cilat ofrojnë këshilla pa pagesë mbi përmirësimin e biznesit, prodhimin dhe zgjerimin për të përfshirë gratë ndërmarrëse</p>	<p>Nr. i bizneseve të grave të përkrahura nga shërbimet e këshillimit të bizneseve Nr. i bizneseve të grave janë përmirësuar dhe zgjeruar</p>	<p>Të dhënat e mbledhura përmes raporteve dhe studimeve</p>	<p>IKAP Institucionet relevante</p>	<p>ABGJ, Donatorët, Zyrat e burimeve njerëzore</p>	<p>2011-2013</p>	<p>€ 12,000 vjetore</p>	

	<p>2.1.5 Përshprehja e ngjarjeve të panairve për bizneset e grave në nivel kombëtar dhe rajonal</p>	<p>Nr. i panairve të organizuar në vit</p> <p>Nr. i bizneseve që kanë marrë pjesë në panair</p> <p>Nr. i bizneseve që janë në gjendje të arrijnë përfitime financiare përmes shitjes së produkteve</p>	<p>Ngjarjet e panairve</p> <p>Të dhënat mbi pjesëmarrjen e bizneseve dhe të hyrave të tyre të mbledhura përmes anketave</p>	<p>ABGJ</p>	<p>MTI, komunat</p>	<p>2011-2013</p>	<p>€ 15,000 vjetore</p>
<p>2.1.6 Intensifikimi i bashkëpunimit me institucionet afërsisht kredidhënëse për të përmirësuar shërbimet e tyre kredidhënëse për gratë ndërmarrëse</p>	<p>Nr. i institucioneve financiare kredidhënëse që përkrahin bizneset e grave</p> <p>Nr. i bizneseve të grave që përfitojnë nga institucionet financiare kredidhënëse</p>	<p>Të dhënat që janë dhënë nga institucionet financiare kredidhënëse</p>	<p>ABGJ, MF</p>	<p>MTI, Institucionet financiare kredidhënëse</p>	<p>2011-2013</p>	<p>€ 5,000 vjetore</p>	

Qëllimi 2: Përkrahja e grave ndërmarrëse dhe arrija e gjasjes së drejtë dhe e shfrytëzimit të resurseve pronësore dhe natyrore							
Aktivitetet	Veprimet	Treguesit	Mënyrat e vërtetimit	Institucion-i(et) përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Plani kohor	Resurset financiare
2.2 Sigurimi që partneritetet publike dhe private dhe investimet i përgjigjen nevojave socio-ekonomike të grave	2.2.1 Identifikimi i ndërmarrjeve ekonomike të leverdishme në të cilat duhet të investojnë gratë dhe ofrimi i informatave mbi mundësitë e investimit në një formë që është e qasshme për gratë	Nr. i ndërmarrjeve të grave janë themeluar  Fuqizimi ekonomik i grave dhe rritja e zgjedhjes së tyre  Procesi i drejtë dhe i hapur i informatave gjatë zhvillimit të PPP-ve	Të dhënat e mbledhura përmes raporteve të monitorimit dhe përgjegjësisë	ABGJ	MTI, MEF, Banka Botërore, MAPL, MPMS, Entitetet biznesore dhe shoqatat	2011-2013	Nuk nevojiten
	2.2.2 Treguesit gjinor të rrymës qendrore të fuqizimit ekonomik në projektet e partneritetit publik dhe privat	Janë themeluar treguesit gjinor dhe janë shfrytëzuar si kritere kyçe në zhvillimin e partneritetit publiko-privat	Dokumenti i propozuar dhe i miratuar i treguesve gjinor  Dekreti mbi përfshirjen e tyre si kriter për zhvillim të PPP-ve	ABGJ	Banka Botërore, MTI, MEF, MAPL,	2012	Nuk nevojiten



	2.2.3 Ofrimi i trajnimit dhe orientimit për institucionet përkatëse mbi ngritjen në rryma qendrore të treguesve gjinor (aftësitë e njohurive praktike) me rastin e zhvillimit dhe zbatimit të PPP-së	Nr. i seancave trajnuese të zbatuara Nr. i Partneriteteve Publiko Private PPP dhe nr. i grave të përfshira si përfituese dhe aktorë kyç	Materialet trajnuese Marrëveshja e PPP-ve	ABGJ	Banka Botërore MTI, MEF, MAPL, komunat	2012- 2013	€ 30,000
--	--	--	--	------	---	---------------	----------

**Qëllimi 2: Përkrahja e grave ndërmarrëse dhe arrija e qasjes së drejtë dhe e shfrytëzimit të resurseve pronësore dhe natyrore**

Aktivitetet	Veprimet	Treguesit	Mënyrat e vërtetimit	Institucionet përkrahëse	Plani kohor	Resurset financiare
2.3 Përkrahja e programeve të cilat promovojnë qasjen e grave, kontrollin si dhe pronësinë e resurseve	2.3.1 Hulumtimi i rolit dhe pozitës së grave në menaxhimin e resurseve natyrore, në nivelin kombëtar dhe zgjerimi i rekomandimeve relevante të cilat përmirësojnë pozitën e tyre si vendim-marrëse dhe përfituese të shfrytëzimit të resurseve natyrore	Hulumtimi përfshinë të dhënat e disagreguara gjinore sipas nivelit të varfërisë, shtresës shoqërore, prapavijës së regjionit, etnicitetit, moshës, arsimimit, etj	MM-të, ngjarjet e organizuara dhe vendimet e ndërmarra	MBPZHR, IFAD, FAO, Banka Botërore, UNDP,	2011- 2012	€ 50,000

	<p>2.3.2 Në bazë të rekomandimeve të tilla, draftimi dhe miratimi i "Dokumentit të bardhë" i cili do të udhëzojë zbatimin dhe inkuorporimin e rekomandimeve të hulumtimit gjatë menaxhimit të resurseve natyrore përmes perspektivës së gjinisë</p>	<p>Dokumenti i bardhë merr pëlqim të gjerë nga sektori i entiteteve politike, private dhe vullnetarëve</p> <p>Nr. i strategjive sektoriale të cilat inkorporojnë udhëzimet e Dokumenteve të bardha</p>	<p>Dokumenti i bardhë</p> <p>Shfrytëzimi i dokumenteve të bardha në udhëzimin e politikave sektoriale</p> <p>Uebfaqja/portali mbi informacionin afarist</p>	<p>QRK</p>	<p>ABGJ, Universitetet, Donatorët</p>	<p>2012</p>	<p>Nuk nevojiten</p>
	<p>2.3.3 Monitorimi i rekomandimeve të zgjeruara dhe udhëzimeve të Dokumenteve të Bardha në politikë-bërje ditore si dhe zbatimi dhe aranzhimet institucionale</p>	<p>Nr. i grave të cilat përfitojnë nga udhëzimet e reja</p> <p>Nr. i grave që marrin pjesë në institucionet përgjegjëse (të nivelit kombëtar, rajonal dhe të komunitetit) për menaxhimin e resurseve natyrore</p>	<p>Raportet e monitorimit, të dhënat e mbledhura</p>	<p>ABGJ</p>	<p>Sektori jo-qeveritar</p>	<p>2013</p>	<p>€ 15,000 vjetore</p>

	<p>2.3.4 Studimi i hulumtimit se si ligjet dhe e drejta zakonore ndikojne ne qasjen e grave në tokë, duke u përqendruar por duke mos u kufizuar në: të drejtat e shfrytëzimit, kontrollit, transferit, rregulloret e shfrytëzimit të tokës, vlerësimi dhe tatueshmëria e tokës.</p>	<p>% e grave në pozita udhëheqëse në institucionet e tilla</p>	<p>Kushtet e punës, propozimi i hulumtimit, raporti i hulumtimit</p>	<p>ABGJ</p>	<p>MBPZHR, MEF, MAPL, komunat</p>	<p>09/2011-08/2012</p>	<p>€ 50,000 (i)</p>
<p>2.3.5 Publikimi i zbulimeve dhe në bazë të zbulimeve të tilla inicimi dhe futja në veprim e ndryshimeve relevante përmes, p.sh. ndryshimeve</p>	<p>Kuptimi dhe miratimi i kompleksitetit të regjimeve të drejtave pronësore siç ndërliiden me rolet dinamike</p>	<p>Publikimet e hulumtimit, legjislacioni, dokumentet e politikës publike dhe të projekteve</p>	<p>ABGJ, Kuvendi i Kosovës</p>	<p>Të gjitha Ministrinë e linjës,</p>	<p>2012-2013</p>	<p>Duhet të vlerësohet</p>	

	<p>legislative dhe ligjeve të reja, politikave dhe rregulloret të reja, projekteve, etj.,</p> <p>2.3.6 Monitorimi i zbatimit të zbulimeve të hulumtimit dhe për krahasim e reformës në sistemin e menaxhimit të tokës</p>	<p>si të meshkujve ashtu edhe grave në shoqëritë e sotme</p> <p>Ofrimi i strukturave efikase institucionale të cilat mund të mbrojnë dhe përforcojnë qasjen e barabartë ndaj tokës brenda kornizës së qëllimeve të veçanta të politikës së tokës së një shoqërie</p> <p>Ngritja e qasjes së grave në tokë</p> <p>Nr. i reformave të miratuara dhe zbatuara</p> <p>Ndryshimet e bëra në kornizën rregulluese</p>	<p>Raportet e monitorimit, publikimet, legjislacioni, politikat publike dhe dokumentet e projekteve</p>	<p>ABCJ</p>		<p>2013</p>	<p>€ 15,000</p>
--	---	---	---	-------------	--	-------------	-----------------

	2.3.7 Përkrahja e grupeve të grave / kooperativave të përfshira në biznes të bujqësisë dhe blegtorisë për t'iu qasur linjave kreditore, teknologjisë, përmirësimi dhe rritja e prodhimit dhe përmirësimi i qasjes në treg	Përmirësimi i statusit dhe produktivitetit ekonomik të grave Përmirësimi i të hyrave familjare Ngritje e qasjes në resurse produktive	Fondet janë alokuar Të dhënat e mbledhura	MBPZHR	ABGJ	2011-2013	Do të përcaktohet
--	---	---	--	--------	------	-----------	-------------------

Qëllimi 3: Të siguruarit që vajzat dhe gratë arrijnë potencialin e tyre të plotë në sistemin e arsimit dhe përmes politikave të trajnimit profesional.

Aktivitetet	Veprimet	Treguesit	Mënyrat e vërtetimit	Institucionet (et) përgjegjëse	Institucionet përkrahëse	Plani kohor	Resurset financiare
3.1. Arritja e pjesëmarrjes së plotë dhe të vazhdueshme të vajzave në arsimim në të gjitha nivelet	3.1.1 Vazhdimi dhe intensifikimi i programeve të vetëdijes së komunitetit mbi rëndësinë e arsimimit të vajzave dhe grave	Nr. i programeve të vetëdijes së komunitetit % e rritur në numrin e regjistrimit të vajzave dhe mbarimit të	Materialet e kampanjës Raportet vjetore bazuar në pjesëmarrjen e disgreguar në shkolla, të dhënat e mbajtjes dhe	MASHT	ABGJ, MPMS, MAPL, Komunitat, organizatat jo-qeveritare (të rinjtë, gratë, komisionet prind-mësimdhënës), Donatorët	2011-2013	€ 25,000 vjetore



	<p>3.1.3 Treguesit e rrjedhës qendrore të ndjeshëm ndaj gjimisë në të gjitha strategjitë ekzistuese arsimore dhe ato të reja</p>	<p>Nr. i veprimeve të ndërmarra për të korrigjuar pabarazitë gjinore si dhe pabarazitë dhe sektori i vullnetarëve</p>	<p>Dokumentet e politikës publike</p> <p>Të dhënat mbi alokimin e resurseve dhe shpenzimeve për vajzat dhe gratë</p> <p>Të dhënat e disagreguara mbi punësimin e grave në përputhje me arsimimin e tyre</p>	<p>MASHT</p>	<p>ABGI, MPMS, MAPL, Komunitat, Organizatat jo-qeveritare (të rinjtë, gratë, grupet minoritare, komisionet prind-mësimdhënës), Donatorët</p>	<p>2011-2013</p>	<p>Do të vlerësohet vjetore</p>
	<p>3.1.4 Pjesëmarrja aktive dhe propozimi i qëllimeve dhe veprimeve konkrete dhe përgjegjëse strategjike gjatë procesit të draftimit të strategjisë së re kombëtare mbi arsimimin dhe trajnimin profesional</p>	<p>% e rritjes së resurseve që alokohen për të përkrahur arsimimin e vajzave dhe grave</p> <p>% e rritjes së numrit të grave të cilat kanë qasje në punë që është në përputhje me arsimimin e tyre</p>	<p>Dokumenti i strategjisë, cilësia e pjesëmarrjes, procesi i diversitetit dhe kontributit</p>	<p>MASHT</p>	<p>ABGI, MPMS, MAPL, MTI, MSH, Komunitat, Organizatat jo-qeveritare (të rinjtë, gratë, grupet minoritare, komisionet prind-mësimdhënës), Donatorët</p>	<p>2011-2013</p>	<p>Të vlerësohet nga MASHT</p>

	<p>3.1.5 Ofrimi i informatave dhe mundësi të trajnimit mbi një sistem dhe lehtësira alternative arsimore për vajza dhe gra të cilat mbesin jashtë sistemit formal shkollos dhe gratë të cilat jetojnë në</p>	<p>Nr. i vajzave dhe grave të cilat ndërmarrin mundësitë e arsimimit dhe trajnimit alternativ</p> <p>Nr. i pakove informative</p>	<p>Fondet e alokuara për mundësi alternative të arsimimit</p>	<p>MASHT dhe MPMS</p>	<p>ABGJ, MPMS, MAPL, MTI, MSH, Komunitat, Organizatat jo-qeveritare (të rinjtë, gratë, grupet minoritare, komisionet</p>	<p>2011-2013</p>	<p>€ 200,000 në vitin e parë, duhet të vlerësohet për vitin vijues</p>
<p>Strategjia përmban veprimet specifike dhe resurse të mjaftueshme që adresojnë pabarazitë gjinore në arsimim profesional dhe qasje në punësim</p> <p>Dokumenti strategjik merr parasysh pabarazitë zhvillimore ndërmjet rajoneve rurale dhe urbane, përkatësisë etnike dhe pabarazitë ndërmjet grupeve etnike</p>							



	strehimore të mbrojtura si viktima të dhunës shtëpiake, trafikimit, prindërve të vetëm, kryesuesve të ekonomive familjare dhe më tej	mbi mundësitë e arsimit dhe trajnimit për vajzat dhe gratë janë prodhuar dhe shpërndarë  Janë ngritur kapacitetet në mesin e grave për të gjeneruar të hyra  Janë rritur zgjedhjet për gratë dhe më tepër kontroll mbi jetët dhe autonominë e tyre	Janë themeluar lehtësirat e infrastrukturës Materialet informative Kurrikula e arsimit alternativ		prind-mësimdhënës), Donatorët		
--	--	--	---	--	-------------------------------	--	--

#### Qëllimi 4: Të zvogëlohet numri i grave që i nënshtrohen varfërisë

Aktivitetet	Veprimet	Treguesit	Mënyrat e vërtetimit	Institucion-i (et) përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Plani kohor	Resurset financiare
4.1 Përkrahja e nënave të vetme, (prind të vetëm, te vjave nga lufta, gratë si kryesuese të ekonomive familjare në rast të paaftësisë së përhershme të	4.1.1 Përmirësimi i të dhënave të disagreguara duke përfshirë treguesit e varfërisë që mbesin të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe zgjerimi i pamjes së varfërisë duke	Sistemi i përmirësuar i të dhënave të disagreguara  Sistemi inkluziv i të dhënave mbi të	Sistemi i të dhënave, Raportet periodike, Mjetet dhe instrumentet e standardizuara për mbledhjen	MPMS	ABGJ, ESK, MAPL, Komunitat, organizatat jo-qeveritare, KE, Donatorët	2011-2013	€ 25,000 në vitin e parë

<p>bashkëshortëve të tyre, nëna të familjeve të mëdha dhe më tej) përmes veprimeve të lehtësimit të varfërisë</p>	<p>përfshirë çështjet kulturore, të të hyrave, fuqisë blerëse, normave tradicionale, madhësisë së familjes, etj dhe periodikisht mbledhja e të dhënave dhe publikimi i raporteve analitike</p>	<p>gjitha aspektet e varfërisë dhe në përputhje me perspektivën e BB-së, BE-së, dhe KB-së mbi çështje të varfërisë në përgjithësi dhe varfërisë së grave, specifiku të Raportet e përmirësuar analitike të publikuara në baza të rregullta</p> <p>Të dhënat e mbledhura dhe të analizuar shfrytëzohen gjerësisht për të rishikuar masat dhe politikat publike ekzistuese dhe draft të reja kundër varfërisë</p>	<p>e të dhënave Janë lëshuar dokumentet e politikës publike</p>	<p>MPMS</p>	<p>ABGJ, MAPL, Komunitat, organizatat jo-qeveritare</p>	<p>2011-2013</p>	<p>€ 500,000 vjetore</p>
<p></p>	<p>4.1.2 Zhvillimi i programeve dhe propozimeve eksperimentale që</p>	<p>% e grave të mënjanuara nga varfëria</p>	<p>Dokumentet e programit/projektit</p>	<p></p>	<p></p>	<p></p>	<p></p>

	<p>përmirësojnë dhe ulin nivelin e varfërisë ndërmjet grupeve të identifikuar</p> <p>4.1.3 Dhënia e mirëqenies shoqërore për këto grupe duhet të mbahet nën rishikim dhe duhet të merren parasysh përmirësime të mëtejme, siç është e përshtatshme në kontekst buxhetor</p>	<p>Nr. i projekteve të zhvilluara dhe zbatuara</p> <p>% e grave që përfitojnë nga programet e tilla dhe që nxjerrën nga varfëria</p> <p>Ndikimi i intervenimeve të tilla eksperimentale në afat-gjatë</p> <p>% e rritjes së resurseve të alokuara për të përkrahur grupet e synuara</p> <p>Statusi i përmirësuar i varfërisë së grave</p> <p>Nr. i veprimeve të ndërmarra për të korrigjuar pabarazitë gjinore dhe pabarazitë</p>	<p>Fondet janë alokuar dhe shpenzuar</p> <p>Raportet e progresit</p> <p>Fondet janë alokuar</p> <p>Janë lëshuar dokumentet e analizës dhe dekretet/politikat publike relevante janë nxjerrë</p>	<p>MPMS</p>	<p>KE, BB, ABGJ, Komunitat</p>	<p>2011-2013</p>	<p>Do të vlerësohet</p>
--	---	---	---	-------------	--------------------------------	------------------	-------------------------

**Qëllimi 4: Të zvogëlohet numri i grave që i nënshtrohen varfërisë**

Aktivitetet	Veprimet	Treguesit	Mënyrat e vërtetimit	Institucion-i(et) përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Plani kohor	Resurset financiare
4.2 Eliminimi i dallimit në paga në baza gjinore.	4.2.1 Kryerja e studimit mbi dallimit ekzistues gjinor të pagave si në sektorin publik ashtu edhe privat , por duke mos u kufizuar në, të dhënat e disagreguara siç janë: ABGJ, niveli i arsimimit, trajnimi formal, rural kundrejt urban, etniciteti, etj.	Raporti studimor përmban të dhënat relevante të disagreguara dhe zgjeron rekomandime specifike afat-shkurtra dhe afat-gjata	Janë alokuar fondet për dokumentin e raportit, mjetet dhe instrumentet hulumtuese	MPMS	ABGJ, ESK, MAPL, MEF, MAP, Komunitat, organizatat jo-qeveritare KE, ILO, UNIFEM, Donatorët, sektori privat	10/2011-06/2012	€ 50,000
	4.2.2 Zhvillimi në bazë të	Të dhënat e mblechura janë inkorporuar në sistemin ekzistues të të dhënave dhe shfrytëzohen periodikisht dhe krahasueshmërisht për të vlerësuar trendët dhe formuluar politika përgjegjëse të reja	Dokumentet e		ABGJ, MAPL,	2012-	Do të

	studimit të tillë, politikat përgjegjëse dhe veprimet e shpejta për të eliminuar pabarazitë e dallimeve gjinore	<p>analitike të përmirësuar janë publikuar në baza të rregullta</p> <p>Nr. i projekteve/ programeve janë zhvilluar dhe zbatuar</p> <p>% e grave që përfitojnë nga programet e tilla dhe që nxjerrën nga varfëria</p>	<p>programit/ projektit</p> <p>Fondet janë alokuar dhe shpenzuar</p>	MPMS	MAP, MF, Komunitat, organizatat jo-qeveritare KE, BB,	2013	vlerësohet
	4.2.3 Sigurimi i monitorimit efikas dhe zbatimi i pagave minimale kombëtare	<p>Janë lëshuar raporte të rregullta monitoruese</p> <p>Nr. i veprimeve ligjore të ndërmarra</p> <p>Nr. i rregulloreve apo ndryshimeve të futura në veprim</p> <p>Zbritja e % së grave të cilat</p>	<p>Raportet e progresit</p> <p>Raportet, të dhënat e besueshme, rregulloret, ndryshimet</p>	MPMS		2011-2013	Do të vlerësohet



		pensionale	Materialët e kampanjës	MPMS	ABGJ,	10/2011-2013	€ 15,000
